



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 249, Datë 08.10.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN VALUE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, dhe nenit 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2381/8 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREEN VALUE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2381 prot., datë 29.08.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 09.09.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.09.2025 dhe 11.09.2025). Njoftimi për fillimin e procedurës së shoqërisë është botuar edhe në faqen e internetit të ERE-s dhe në rrjetet sociale. Duke qenë se u konstatua një gabim material në publikimin në media (ishte referuar si aplikuese shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe jo “GREEN VALUE” sh.p.k., në datat 17.09.2025 dhe 18.09.2025 u botua korrigjimi i gabimit përkatës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.09.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- ERE, me shkresën nr. 2381/4 prot., datë 10.09.2025, ka ftuar shoqërinë në një seancë dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që lidhet me mbështetjen financiare për ushtrimin e veprimtarisë.

- Në seancën e zhvilluar në mjediset e ERE-s, në datën 18.09.2025, shoqëria ka dhënë sqarimet përkatëse dhe në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2381/7 prot., datë 19.09.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.
- Për sa njoftuar nga vetë shoqëria se stafi teknik do t’i shtohet strukturës së saj organizative pas licencimit dhe përpara fillimit të aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike, vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik.
- Shoqëria i disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së nënqirasë përfundon më 26.08.2029 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GREEN VALUE” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik.
3. Brenda datës 26.09.2029, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit/mosplotësimit të sa përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN VALUE” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI